

Syllabusi i lëndës

Lënda: Tefsir IV – *Komentimi tematik i Kuranit*

Programi i studimit: Studime Islame

Numri i ECTS kredive: 6

Statusi i lëndës: O

Kodi i lëndës: 411

Fondi i orëve: 3+2

Viti akademik: 2026/2027

Semestri: VIII

Mësimdhënësi: Prof. ass. dr. Lulzim Esati **Kontakti:** e-maili: lulzimesati@gmail.com

Përmbajtja e shkurtër e lëndës:

Përmbajtja e lëndës: “**Tefsir tematik**” (kjo lëndë përfshin një numër të temave të nxjerra nga Kurani famëlartë. Të përpunuara sipas metodës së tefsirit tematik, që përfshijnë çështje të ndryshme si nga fusha e besimit dhe adhurimit ashtu edhe nga jeta praktike e së përditshme, në rrethin dhe shoqërinë ku edhe jetojmë.

Qëllimi i lëndës:

Pajisja e studentëve me njohuri bazë nga lëmi i interpretimit dhe komentimit tematik të Kurani Kerimit, duke hulumtuar dhe studiuar temat më të rëndësishme që kanë të bëjnë si me individin ashtu dhe me shoqërinë. Zhvillimi i shkathtësive dhe aftësive për të analizuar çështjet të ndryshme të cilat përfshin programi studimor në mënyrë që të mund të nxjerrin tema aktuale nga libri i Allahut s.v.t. Fitimi dhe avancimi i sensit kritik në aspektin e vlerësimit të argumenteve bazuar në libri i Allahut s.v.t. Aftësimi për të shkruar tema të ndryshme nga Kurani Famëlartë, në një stil të pastër dhe bindës të shprehurit me gojë dhe me shkrim, tipare këto të një personi me një edukim liberal akademik. Prej leksioneve nga lëmi i tefsirit tematik. presim që studenti pas përfundimit të këtij kursi do të përfitojë njohuri të bollshme mbi trajtimi e temave në mënyrë direkt nga Kurani famëlartë dhe hulumtimin e çështjeve të rëndësishme sipas metodologjisë së tefsirit tematik që është nga metodat më bashkohore në shkencën e komentimit dhe interpretimit të Kuranit Famëlartë. Të kuptojë proceset e zhvillimit në fushën e tefsirit tematik që nga etapat e para të kësaj shkence e deri në ditët e sotme. Si dhe ti jepet mundësi studentit që në formë kritike duke nxitë debate, të jenë sa më objektiv dhe progresiv në nxjerrjen e temave nga Kurani Famëlartë posaçërisht atyre që kanë karakter religjioz

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të kursit, studenti do të jetë në gjendje:

Të përshkruaj etapat e zhvillimit të tefsirit tematik gjatë historisë.

Të krahasoj ndërmjet temave të ndryshme të cilat i studion gjatë kursit.

Të diskutoj rreth këtyre temave në bazë të argumenteve të secilit interpretues, duke qenë sa më objektiv në parashtrimin e tyre.

Të mbroj qëndrimet e secilit interpretues, ashtu siç i konceptojnë ithtarët e tyre.

Të prezantoj mendimin kritik ndaj secilit prej tyre, duke ia parashtruar argumentet e secilës shkollë të tefsirit.

Të jetë në gjendje që njohuritë e fituara t'i aplikoj gjatë trajtimit të temave dhe çështjeve të ndryshme ndërfetare.

Metodologjia e mësimdhënies:

Mësimi do të zhvillohet sipas metodës së studimit komparativ dhe atij analizues. Përmes ligjëratave, ushtrimeve dhe diskutimeve interaktive.

Përmbajtja e lëndës:

Java e parë: Hyrje, Njohja me syllabusin, metoda, organizimi, kërkesat dhe vlerësimi. Shqyrtime të përgjithshme: Kontributi i dijetarëve islam të mëhershëm për tefsirin tematik dhe përdorimi i kësaj metode në komentimet tyre.

Literatura: Dr. Lulzim Esati, *Tefsiri tematik*- shembuj nga Kurani kerimi, (*Në vazhdim do të jetë kjo literaturë bazë, andaj do të mjaftohemi vetëm me cekjen e faqeve*).

Java e dytë: Zotimet e marra nga Besimtarët musliman, zotimet që ndërlidhen me Zotin fuqiplotë, zotimet që lidhen direkt me trajtimin e pakicave në shtetin Islam. Shembuj nga historia që dëshmojnë përmbajtjen e muslimanëve ndaj këtyre zotimëve.

Propozimi i temave për punime seminarike dhe për ese.

Bisedë interaktive, rreth këtyre zotimëve, opinionet e dijetarëve të mëhershëm rreth përmbushje së këtyre zotimëve nga muslimanët.

Literatura: F: (340-357). Komentimi tematik i Kuranit.

Java e tretë: Rëndësia e dhikrit në Kurani Kerim – roli i dhikrit (përmendje së Allahut) në rehabilitimin e zemrës së njeriut. Pasojat e mos përmendjes së Zotit, në sjelljen e individit. Mënyra, koha dhe fjalët e dhikrit, sipas Kuranit famëlartë.

Literatura: F: (212-220). Komentimi tematik i Kuranit.

Java e katërt: Pendimi i sinqertë sipas Kuranit F. Si dhe kushtet e pendimit të sinqertë. Babai i njerëzimit-Ademi a.s.- shembull për pendimin e sinqertë. Shembuj nga

pejgamberet a.s. në pendimin e tyre. Frytet e pendimit të sinqertë në këtë jetë dhe në jetën tjetër.

Literatura: f: (158-162). Komentimi tematik i Kuranit.

Java e pestë: Zotimet e marra nga të krishterët sipas Kuarani Kerimit. Dhe dëshmi nga Kurani f. Rreth zotimëve që janë marrë nga Isau a.s. për çështjet që kanë të bëjnë me Zotin fuqiplotë, për adhurimin dhe për Muhamedit a.s. Dëshmitë nga Bibla që përputhem me disa zoime të përmendura në Kuran.

Literatura: f: (322-340). Komentimi tematik i Kuranit.

Java e gjashtë: Krenaria sipas Kuranit famëlartë, shkaqet e krenarisë në Kuran, si dhe dallimi i krenarisë në Kuranin famëlartë nga krenaria bashkkohe. Vlerat e të qenurit krenar sias Kuranit, dhe vlerat që dominojnë sot në shoqëri, arsytet dhe dallimet.

Literatura: f: (151-159). Komentimi tematik i Kuranit.

Java e shtatë: Detyrimi i njeriut ndaj jomuslimanit, argumentet nga Kurani që japin kornizën e qartë se si të sillet muslimani me jomuslimanët gjatë bashkjetesësë, (tregtia, ushqimet e martesat etj.). rrespekti i besimimëve të tyre. Debati në formën më të bukur me ta rreth çështjeve që nuk pajtohem me jomuslimanët (ithtar të librit, pagan. Ateist e të tjerë). Shembuj nga Kurani f. rreth mirësjelljes së muslimanëve me jomuslimanët.

Literatura: f: (47-54). Komentimi tematik i Kuranit.

Java e tetë: Testi intermedier

Java e nëntë: Ajetet që ndalojnë korrupsionin, ajetet që bëjmë të qartë mënyrën e vetme të përfitimit nga pasuria e tjetrit. Ajetet që tregojnë për pasojat e korrupsionit, si dhe një pasqyrë e qartë rreth (%) së korrupsionit në botën arabe.

Literatura: f: (20-30). Komentimi tematik i Kuranit.

Java e dhjetë: Sinqeriteti, në Akide- Besim, Ibadet- Adhurim, Dua, etj. Në Kurani Kerimi.

Shembuj praktikë nga libri i Allahut s.v.t. , që vërtetojnë se sinqeriteti i jep besimtarit një imunitet të veçantë ndaj intrigave të djallit. a.l.

Literatura: f: (165-172). Komentimi tematik i Kuranit.

Java e njëmbëdhjetë: Konflikti i parë njerzor në Kuranin famëlartë- rrëfimi i dy bijëve të Ademit a.s. në Kuran, na mëson për krimin e parë njerëzorë në histori. Konsekuencat e këtij krimi për brezat më pas. Mëkati që bartë Kabil vrasësi, përballë sjelljes së mirë të Habilit-viktimës. Mbytyja e një njeri, llogaritet si mbytyje e tërë njerëzimit sipas Kurnit famëlartë.

Literatura: f: (109-118). Komentimi tematik i Kuranit.

Java e dymbëdhjetë: Modeli i njeriut të mirë në Kuran- personi në fjalë ishte i biri i axhës së Faraonit që i doli në ndihmë Musaut a.s., duke e rrezikuar kështu jo vetëm pushtetin që kishte por edhe jetën, andaj u zgjodh si model i mirë për njerëzit pas tij, që duan t'i mbrojnë vlerat e mira në shoqëri. Dhe për atë se si duhet të mbrohet e drejta përballë pushtetraëve të mdhenjë. Kurani

afron debatin në detaje të përsosur në fjalë me Faraonin, ku ishte i pranishëm edhe peygamberi Musau a.s.

Literatura: f: (139-150). Komentimi tematik i Kuranit.

Java e trembëdhjetë: Detyrimi i njeriut ndaj fqinjët musliman në Kurani Kerim. Detyrimi i Muslimanit ndaj fqinjët jo musliman në Kurani Kerim.

Literatura: f: (31-44). Komentimi tematik i Kuranit.

Java e katërbëdhjetë: Rizku- furnizimi dhe shkaqet e tij në Kuran- roli i kontributit të njeriut në rizk/furnizim. Arsyet e shtimi të rizkut, dhe shkaqet e pakësimit të rizkut në Kuranin famëlartë.

Literatura: f: (251-261). Komentimi tematik i Kuranit.

Java e pesëmbëdhjetë: Provimi final

Literatura: Kur'ani Kerimi, me përkthim nga efendi Hasan Nahi. Botimi 1986.

Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjeratë 10 pikë

Punimi seminarik 20 pikë

Testi intermedier 30 pikë

Provimi final 40 pikë

Total 100 pikë

Literatura obliguese:

1. Prof. ass. dr. Lulzim Esati, tefsiri tematik- shembuj nga Kurani kerimi, libër pranë botimit, për vitin e katërt, Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë, 2014.

Literatura shtesë dhe bibliografia:

1. Sh.Ahmeti, *KUR'ANI –përkthim me komentim në gjuhën shqipe. I shtypur në kompleksin e hsëbyesit të dy haremeve, në medine 1413 h.*
2. *Kandili ndriçues*, versioni e shkurter i tefsirit të Ibën Kethirit- përktheu Mr. Bashkim Aliu, i botuar nga fondacioni i rinisë islame në Cyrih, 2007.
3. Muhamed el-Gazali, *“Komenti Tematik i Kuranit Famëlartë”*, sh.b. Logos, 2007, shkup.
4. 44. Vehbet Ez-Zuhejli, *et-Tefsirul Munir*, sh.b: Darul fikri elmuasir, Bejrut, 1991.

Kontributi në ngarkesën e studentit

Aktiviteti	Orë	Ditë\Javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktime me mësimdhënësin\konsultimet	1	10	10
Ushtrime në terren			
Kollokfiume, seminare, ese	1	10	10
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	10	10
Përgatitja përfundimtare për provim.	5	2 ditë	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, ese, provim final)	3	5 ditë	15
Totali	16	15 javë	125